



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

POLITIKA PËR NDËRKOMBËTARIZIM

Politika për ndërkombëtarizim e Kolegjit BIZNESI” është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, Statutin e Kolegjit neni 81, në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor i datës 25/09/2020, miraton:

POLITIKA PËR NDËRKOMBËTARIZIM

Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, nga ana e universiteteve të vendeve të ndryshme gjithnjë e më shumë është përkrahur koncepti i ndërkombëtarizimit të institucioneve të arsimit të lartë. Por, me fillimin e shekullit të XXI, ndërkombëtarizimi në arsimin e lartë s’paraqet më vetëm një teori, por shumë më tepër, paraqet një realitet dhe domosdoshmëri të universiteteve. Vështruar nga aspekti i perspektivës globale, mund lirisht të konstatojmë se bota është duke ndryshuar me shpejtësi me intensitet të lartë. Kufijtë ndërkombëtar janë duke u reduktuar dukshëm nga mediumet masive, investimeve korporative, migrimet njerëzore, lëvizjet së fuqisë punëtore dhe përmirësimi i mjeteve të transportit, proces i cili mund të përmblihet si koncept i globalizimit. Me këtë rast, mund të theksojmë mendimin që ndahet prej të gjithëve se pjesëmarrja në organizata rajonale dhe ndërkombëtare është shumë e rëndësishme për Kolegjin Biznesi dhe për këtë shkak universitet në vende të vogla duhet të jenë shumë aktive në raport me këto transformime strukturore të mëdha të sistemit ndërkombëtar.

Si përgjigje për këtë realitet global, organet udhëheqëse dhe stafi akademik i Kolegjit Biznesi kanë ndërmarrë shumë iniciativa të rëndësishme për ndjekjen e trendit të funksionimit dhe zhvillimit të universitetit si universitet bashkëkohor në përputhje me trendët global. Megjithatë, që të jetë në trend me ndryshimet që ndodhin, universiteti duhet të nisë një përpjekje për zgjerimin e natyrës ndërkombëtare të politikave, aktiviteteve bashkëvepruese, partneriteteve dhe planeve mësimore.

Kolegji Biznesi që prej momentit të themelimit në vitin 2004, në nivel institucional ka qenë i kyçur në shumë aktivitete ndërkombëtare me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara të tij. Sidoqoftë, në vitet e fundit, profili ndërkombëtar i KB-së është rritur dukshëm në programet e shkëmbimit të studentëve dhe stafit akademik, në realizimin e projekteve dhe aktivitete të tjera.

Vizioni i Kolegjit Biznesi në esencë shprehën intencat e tija që të “jetë qendër udhëheqëse e përsosmërisë akademike në Republikën e Kosovës dhe më gjerë në rajon dhe Evropë”. Në deklaratën e vlerave të Kolegjit përkrahët ndërkombëtarizimi përmes participimit në botën globale të shkëmbimit të përvojave, studentëve dhe stafit akademik, duke pranuar dhe dhënë bursa në nivel ndërkombëtar, me qëllim të rekrutimit të stafit dhe studentëve ndërkombëtarë. Vizioni dhe vlerat e ndërkombëtarizimit bëjnë të domosdoshme që studentët dhe stafi të ndërkombëtarizojnë të gjitha kërkesat dhe analizat e tyre intelektuale. Për të arritur këtë, të gjithë anëtarët e komunitetit të Kolegjit Biznesi duhet të kujdesen për një ambient aktiv të hulumtimit, mësimdhënies dhe të aktiviteteve tjera të ndërsjella në baza të rregullta me intelektualët nga i tërë globi. Vetëm duke e bërë këtë, komuniteti i Kolegjit Biznesi mund të pranojë dije dhe shkathtësi të larta që janë të nevojshme për t’i shërbyer interesit të popullit dhe vendit të vetë dhe njëkohësisht të ndërmarrë studime dhe hulumtime të përbashkëta në nivel të barabartë me partnerë nga jashtë.

Përderisa në njërën anë vizioni i Kolegjit inspiron stafin e tij dhe studentët që të arrijnë në tërë botën, në anën tjetër, universiteti duhet shumë shpejtë të kthehet në destinacion atraktiv për studentët dhe stafin nga shumë vende të huaja, të cilët duan të studiojnë ose të ndërmarrin hulumtime në Republikën e Kosovës. Në mënyrë të veçantë do të jetë e rëndësishme të theksohet, se ndërtimi dhe sigurimi i një ambienti hulumtues-shkencorë është njëri prej shkaqeve që do të ndikojë në nxitjen e kësaj tendence, duke konfirmuar pohimet se universiteti është një prej institucioneve më të pajisura në aspekt teknik dhe teknologjik dhe me staf kompetent akademik dhe shkencorë në këtë pjesë të vendit.

1. DEFINIMI

Për qëllimet e këtij dokumenti të politikës, **ndërkombëtarizimi** nënkupton: *“përfshirjen e dimensionit ndërkombëtar përmes planeve mësimore; pasurimin e diversitetit ndërkombëtar të aktiviteteve kulturore dhe sportive; zgjerimit të numrit të studentëve dhe stafit ndërkombëtar në participimin në aktivitetet e Kolegjit; dhe rritjen e mundësive për studentët dhe stafin e Kolegjit që të studiojnë dhe përfitojnë eksperiencë në vendet tjera të botës dhe kultura tjera”*

2. QËLLIMET E NDËRKOMBËTARIZIMIT DHE AKTIVITETET PËR IMPLEMENTIM

Politika e ndërkombëtarizimit të Kolegjit Biznesi përpiket që të realizoj tri objektiva kryesore të përcaktuara dhe të cilat janë paraqitur më poshtë. Kështu që, nën secilin objektiv, janë numëruar aktivitetet kryesore me të cilat stafi dhe studentët mund të realizojnë secilin objektiv. Mjete tjera shtesë mund të jenë po aq të dobishme si përvojë në rritjen e procesit të ndërkombëtarizimit. Është e pritur që çdo njësi brenda Kolegjit të rishikojë objektivat dhe aktivitetet e më poshtme për të përcaktuar objektivin (at) e caktuar dhe aktivitetet në të cilën ajo do të përqendrohet në secilën pikë të caktuar në planifikimin e tij strategjik. Është parashikuar që të gjithë njësitë (programet studimore) do të marrin pjesë në procesin e ndërkombëtarizimit. Për secilin objektiv janë përcaktuar pikat e referimit (Benchmarks) që të mundësohet monitorimi i realizimit institucional në lidhje me aktivitetet e ndërkombëtarizimit.

2.1. QËLLIMI I PARË: Zgjerimi i aktiviteteve për mobilitet ndërkombëtar të studentëve dhe të stafit akademik

Aktivitete:

- Siguron mundësinë për studentët e KB që të kalojnë një semestër ose një vit jashtë përmes aktiviteteve të shkëmbimit të studentëve ose stafit akademik;
- Ndhmon stafin akademik që të ndërmarrë studim ose hulumtim jashtë vendit për periudhë përkatëse për qëllimin profesional të tyre;
- Rekruton mësimdhënës të jashtëm që sjellin kapacitetin e nevojshëm për hulumtim ose mësimdhënie;
- Promovon mundësi studimi afatshkurta dhe afatgjata në KB për studentë të huaj (ndërkombëtarë) duke u ofruar kurse në lëndë të ndryshme në gjuhën angleze;
- Zhvillon partneritete që ndihmojnë ekspansionin e shkëmbimit të studentëve dhe stafit.

Të dhëna për pikat e referimit (Benchmark Data)

- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare e mirëmban listën e Memorandumeve për bashkëpunim dhe për partneritet aktiv të shkëmbimit;
- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare përpilon raporte për studentët që janë jashtë gjatë çdo semestri;
- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare raporton në fund të çdo viti për numrin e studentëve ndërkombëtar të regjistruar për afat të gjatë në KB;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për mësimdhënësit nga jashtë të bashkangjitur në programin studimor për qëllime hulumtimi dhe detyrat specifike që ato i kanë në njësi;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për plan programet që planifikohen për studim jashtë ose që operohen për studentët ndërkombëtar;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për stafin akademik që ka ndërmarrë hulumtim ose studim jashtë vendit.

2.2. QËLLIMI I DYTË: zgjerimi i aktiviteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar në hulumtimin shkencor

Aktivitete:

- Angazhim në hulumtim më bashkëpunëtor ndërkombëtar;
- Rekrutim të mësimdhënësve shkencor të jashtëm për të mbikëqyrë ose drejtuar projekte hulumtuese të programeve studimore;
- Ndërtimi i mekanizmave për mbikëqyrje kooperative të studentëve të diplomuar të regjistruar në KB dhe në institucionet partnere nga mësimdhënësit e KB-së dhe të kolegëve partner;
- Nxitja (inkurajimi) e studentëve të jashtëm që kanë shkathtësi hulumtuese për participim në projektet hulumtuese të KB;
- Të prezantojnë më shumë punime shkencore në konferenca ndërkombëtare;
- Të sigurojnë vendtakim për stafin e KB ku do të informohen kolegët për punimet dhe diskutimet e konferencave ndërkombëtare;
- Zhvillim i partneriteteve që do të zgjerojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në hulumtim.

Të dhëna për pikat e referimit (Benchmark Data)

- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare e mirëmban listën e Memorandumeve për bashkëpunim dhe për partneritet aktiv të shkëmbimit;
- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare raporton në fund të çdo viti për participimin e studentëve ndërkombëtar në partneritete aktive hulumtuese në Kolegj;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për anëtarët e stafit që kanë marrë pjesë konferenca ndërkombëtare dhe për rezultatet e rëndësishme të arritura;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për mësimdhënësit ndërkombëtar (përfshi këtu edhe studentët e diplomuar) që punojnë bashkë me anëtarët e programit studimor në projekte të përbashkëta hulumtuese gjatë semestrit;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për punimet shkencore që janë rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar;

- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për mësimdhënësit nga jashtë që marrin pjesë në mbikëqyrjen e të diplomuarve.

2.3. QËLLIMI I TRETË: zgjerimi i aktiviteteve të ndërkombëtarizimit të planeve mësimore

Aktivitete:

- Zhvillon plane mësimore që të diplomuarit e KB i bën më konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës;
- E rritën kuptimin e vlerësimit të fakultetit dhe studentit për diversitetin ndërkombëtar;
- Inkurajon studimet e gjuhëve të huaja;
- Krijon programe studimore të përbashkëta ose të dyfishta me universitete të jashtme, kur programe të tilla s'janë të mundshme ose s'mund të realizohen në KB;
- Mundëson punë praktike jashtë vendit për studentët e KB;
- Merr pjesë në kurse on-line të ofruara nga vendet e jashtme dhe ofron kurse të tilla në KB për studentët në vendet tjera;
- Implementon qasje fleksibile për transferim të kredive nga universitetet e akredituara prej vendeve tjera.

Të dhëna për pikat e referimit (Benchmark Data)

- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare raporton në fund të vitit për matjet e diversitetit ndërkombëtar në universitet, duke përfshirë numrin e vendeve prej të cilëve studentët ndërkombëtar vijnë, diversitetin ndërkombëtar të stafit akademik dhe kurset me përmbajtje eksplicite ndërkombëtare;
- Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare gjatë vitit vlerëson praktikatat e transferimit të kredive për fleksibilitetin e tyre dhe shfrytëzimin e lehtë të tyre prej studentëve;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për ndryshimet në plan programet që sjellin rritje të ndërkombëtarizimit në programet e tyre;
- Departamenti i gjuhëve në fund të vitit raporton për numrin e studentëve që kanë ndjekur kurset e ofruara për gjuhët e huaja;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për pjesëmarrësit në kurset on-line të ofruar për studentët e huaj dhe numrin e studentëve të KB që kanë ndjekur kurset e tilla jashtë vendit;
- Përgjegjësi i Zyrës raporton në fund të vitit për secilin program studimor të përbashkët ose të dyfishtë të krijuar dhe me këtë edhe numri i studentëve të regjistruar.

3. DIREKTIVAT E POLITIKËS PËR NDËRKOMBËTARIZIM

Edhe pse një numër i madh i primeve vepruese do ta udhëheqin procesin për ndërkombëtarizim në Kolegjin Biznesi, ndër më të rëndësishmit do t'i theksojmë:

- **Motivimi i stafit:** suksesi i kësaj politike kërkon që një numër i madh i anëtarëve të stafit jashtë detyrave të tyre të zakonshme të japin kontribut të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e Kolegjit. *Stafi i këtille duhet të marrë trajtim special përmes sistemit të pagesave dhe në procesin e promovimit, gjithashtu një përkrahje speciale duhet të jetë e mundshme për ato që kërkojnë bursa ndërkombëtare konkurruese.*

- **Roli i programeve studimore në procesin e ndërkombëtarizimit:** *Secili program studimor duhet të ndërtojë plan për ndërkombëtarizim.* Këtu duhet të përfshihen çështje si nevojat e stafit, ndryshimet e plan programeve, objektivat e hulumtimit, rekrutimi i studentëve, puna praktike, ndërtimi i qendrave të ekselencës dhe programeve speciale. Programet ndërkombëtare efikase gati se çdo herë janë interdisciplinare. Të gjitha njësitë duhet ta kenë qartë që të marrin para sysh këtë çështje në planifikimin e tyre. Programet studimore duhet të bëjnë përgatitje për involvimin e mësimit dhe studentëve pjesëmarrës në organizimin dhe programin e tyre.

- **Zhvillimi dhe miratimi i partneriteteve ndërkombëtare:** programet studimore kanë përgjegjësi primare për identifikimin e institucioneve partnere ndërkombëtare. Institucionet dhe programet partnere duhet të kenë reputacion ndërkombëtar për ekselencë në raport me fushat e bashkëpunimit. Për më tepër, bashkëpunimi duhet: a) të ketë objektiva të caktuara qartë që i mbështesin qëllimet strategjike të programeve studimore; b) përfitimi i ndërsjellë i KB dhe universiteteve tjera pjesëmarrëse; c) kanë një ose më tepër anëtarë të stafit të identifikuar me përgjegjësi primare nga ana e KB për bashkëpunim; d) të jetë në aspekt financiar i qëndrueshëm; e) të ketë marrëveshje të nënshkruar që artikulon parimet dhe praktikën e veprimit për të drejtuar bashkëpunimin. Përpara se të nënshkruhet prej Dekanit të Kolegjit, Memorandumi për bashkëpunim, Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare duhet të përcaktojë nëse janë përmbushur kriteret e lartpërmendura.

- **Distribuími gjeografik i partneriteteve:**

Aktualisht shumica e marrëveshjeve formale të universitetit janë me institucione nga Shqipëria, Maqedonia, Ballkani dhe Evropa. Por është me rëndësi që universiteti në kuadër të përmbushjes së misionit dhe vizionit të vetë të synojë të bëhet qendër për ekselencë në rajon, dhe të krijojë partneritete strategjike me institucionet e arsimit të lartë të vendeve që janë super fuqi ekonomike të së ardhmes. Përderisa pandërprerë kërkon partneritete në rajonin e Ballkanit, universiteti ka për synim që të ndërtojë partneritete me institucionet e vendeve të Evropës perëndimore dhe më gjerë.

- **Financimi i aktiviteteve ndërkombëtare:**

Nga kjo politikë do të kërkohen një sërë qasjesh të reja në financim. E para, Universiteti do të menaxhojë me buxhet special që ka të bëjë me: a) promovimi i lidhjeve ndërkombëtare; dhe b) stipendi për shkëmbimin e studentëve. Që të dyja do të jenë të financuara nga fondet e universitetit. E dyta, Zyra do të fillojë të mobilizojë fonde shtesë për financimin e këtyre lidhjeve dhe shkëmbimet. Këto fonde do të vijnë prej burimeve si grante ndërkombëtare, donacione, fonde të ndihmës, pagesa të studentëve ndërkombëtar, të hyra prej programeve speciale dhe të ardhura nga komercializimi i hulumtimeve me partnerët ndërkombëtar. Përveç këtyre mënyrave të reja të financimit, pritet që programet studimore do të vazhdojnë që të kërkojnë fondet e tyre për përkrahjen e aktiviteteve të tyre ndërkombëtare.

- **Organizimi administrativ i kësaj politike:** Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare duhet të sigurojë drejtim dhe përkrahje të aktiviteteve të stafit që shërbejnë për implementimin e kësaj politike për ndërkombëtarizim. Për më tepër, është e pritshme që Zyra të këshillojë, monitorojë dhe ndihmojë programet studimore në aktivitetet e tyre për ndërkombëtarizim. Pasi që Zyra mundet më së miri t'i përmbushë këto përgjegjësi, të gjitha njësitë e Kolegjit duhet ta informojnë Zyrën për iniciativat e reja dhe progresin e që është bërë në marrëdhëniet dhe projektet ndërkombëtare ekzistuese të universitetit. Si rregull e përgjithshme, ndarja e ardhshme e përgjegjësive duhet të shqyrtohet duke respektuar administrimin e aktiviteteve ndërkombëtare në KB:

a) *Në rastin e aktiviteteve që janë në lidhje me hulumtimin dhe mësimdhënien, përgjegjësia primare për identifikimin dhe implementimin e iniciativës qëndron në programet studimore. Këto njësi të Kolegjit duhet të organizojnë vizitat në universitetet jashtme të inkuadruar në partneritet me KB. Në rast se hulumtuesit vijnë prej jashtë që të ndër marrin hulumtim në ombrellën e njësisë së Kolegjit, do të duhet që njësia të marrë përgjegjësinë që të njoftojë hulumtuesin për marrjen e lejes për hulumtim dhe ta ndihmojë hulumtuesin deri sa është e mundur në procesin e marrjes së lejes për hulumtim. Gjithashtu, programet studimore duhet ta informojnë Zyrën për marrëdhënie ndërkombëtare për natyrën gjenerale të bashkëpunimit ndërkombëtar që është zhvilluar dhe për aktivitetet për implementimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.*

b) *Zyra për shkencë dhe hulumtime shkencore duhet të ketë përgjegjësi primare për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e granteve ndërkombëtare për hulumtim shkencor. Është e pritur që përgjegjësi i Zyrës për hulumtime shkencore në kushte përkatëse do të kërkoj ndihmë prej Zyrës për marrëdhënie ndërkombëtare në zhvillimin e propozim granteve të veçanta ndërkombëtare për hulumtim edhe po që se këto grante nuk janë në menaxhmentin e implementimit të granteve të tilla kur financimi ka qenë i pranuar.*

c) *Zyra për menaxhim me cilësi duhet të jetë përgjegjëse për sigurimin që programet e zhvilluara dhe të implementuara nën këtë politikë janë të evaluuara (vlerësuar) në përputhje me politikën për sigurimin e cilësisë të Kolegjit. Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare duhet ta ndihmojë Zyrën për menaxhim me cilësi në grumbullimin e informacioneve të nevojshme për evaluimin e kësaj.*

d) *Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare duhet të marrë përgjegjësinë primare për ato funksione të shërbimeve ndërkombëtare që janë më mirë të administruar në mënyrë kolektive dhe janë në shërbim të të gjitha njësive akademike. Funksione e ardhshme janë më të përshtatshme për këtë qasje kolektive:*


1. Këshillon të gjithë njësitë e Kolegjit për aktivitetet e tyre për ndërkombëtarizim,
2. Rekruton studentë ndërkombëtarë,
3. Menaxhon pranimin të studentëve ndërkombëtar në bashkëpunim me stafin akademik dhe komisionin për pranim të studentëve,
4. Menaxhon shërbimet për studentët ndërkombëtarë,
5. Gjetja e fondeve dhe administrim të buxhetit për lidhje ndërkombëtare,
6. Menaxhon bashkëpunimet për të cilat numër i madh i njësive të Kolegjit kanë interes;
7. Mbështetje në përpilimin dhe implementimin e bashkëpunimeve zyrtare,
8. Ndihmë në zhvillimin e aplikimit për grante ndërkombëtare për hulumtim,
9. Pajis Përgjegjësin e zyrës me protokoll të nevojshëm për aktivitetet ndërkombëtare,
10. Monitoron progresin në lidhje me pikat e referimit të theksuar më lartë,
11. Dorëzon raport vjetor në KLMSH në fund të vitit akademik (zakonisht muaji Shtator) mbi progresin në lidhje me pikat e referimit.

4. IMPLEMENTIMI

Implementimi i kësaj politike është përgjegjësi e Zyrës për marrëdhënie ndërkombëtare dhe programeve studimore në kuadër të Kolegjit. Secili program studimor në kuadër të Kolegjit duhet të diskutoj se cilat prej objektivave të sipërpërmendura do të jetë në fokusin e tyre në kuptimin e resurseve dhe kohës së stafit. Zgjedhja duhet të jetë konzistente me objektivat strategjike të Kolegjit dhe njësisë së involvuar. *Është e pritur që brenda afatit prej pesë viteve,*

secili program studimor do të ketë ndërmarrë në mënyrë të suksesshme më së paku një iniciativë të rëndësishme ndërkombëtare.

Prishtinë, me ____/____/2020



KLMESH i Kolegjit BIZNESI
Kryetari

Prof dr Shyqeri Kabashi/